

## **Neni 1**

### **Objekti i Rregullores**

Rregullorja në fjalë ka si objekt disiplinimin e menaxhimit të mbetjeve urbane voluminoze të gjeneruara në territorin e Bashkisë Himarë, i cili do të kryhet në mënyrë të tillë që të sigurojë një mbrojtje të lartë të mjedisit.

Menaxhimi do të kryhet duke respektuar të gjitha parimet e efikasitetit dhe ekonomizimit të shpenzimeve.

## **Neni 2**

### **Qëllimi**

Objektivi dhe qëllimi i rregullores do të jenë:

- Shmangia e braktisjes së mbetjeve voluminoze në territorin e bashkisë;
- Krijimi i lehtësive për qytetarët lidhur me transportin dhe trajtimin e mbetjeve voluminoze;
- Sigurimi i një menaxhimi korrekt të këtyre mbetjeve, duke garantuar një trajtim të vazhdueshëm dhe duke favorizuar, në se është e mundur rikuperimin e materialeve;
- Rritja e sasisë së mbetjeve të selektuara.

## **Neni 3**

### **Tipologjia e materialeve të cilët do të mblidhen në banesë**

Mbledhja e mbetjeve në banesat e klientëve familiarë do të organizohet ekskluzivisht për mbetjet e mëposhtme:

- Mbetje voluminoze;
- Të mira materiale të qendrueshme për përdorim shtëpiak.

Në zbatim të kësaj rregulloreje, në kategorinë e mbetjeve voluminoze bëjnë pjesë të gjitha llojet e mobiljeve dhe pajisjeve, të cilat për shkak të përmasave të tyre, nuk mund të transportohen nga qytetarët me mjetet e tyre drejt Qendrës Ekologjike Bashkiake. Të tilla janë:

- Mobilje
- Lavatriçe
- Divane
- Susta krevati
- Aparatura elektronike (TV, kompjutera)
- Frigoriferë
- Karrike
- Biçikleta
- Mjete elektrike
- Pajisje elektroshtëpiake të mëdha (furra, etj.)
- Kolltuqe
- Dyshekë

- Pajisje kuzhine (lavastovilje, furra me mikrovalë, ngrirës)
- Printera
- Skanera
- Tavolina zyre
- Biblioteka
- Komodina
- Mbetje të tjera elektrike
- Goma
- Bateri

#### **Neni 4**

### **Shërbimi i mbledhjes në banesë**

Shërbimi i mbledhjes së materialeve voluminozë në banesë do të kryhet pas njoftimit të dërguar nga qytetari. Për të përfituar shërbimin, klientët duhet t'i drejtohen paraprakisht, përfshi edhe njoftimin me telefon, Zyrës së..... në Bashki, e cila bën regjistrimin e prenotimeve. Dërgimi i kërkesave do të bëhet një javë përpara marrjes së shërbimit dhe regjistrimi i tyre do të bëhet në një regjistër të veçantë.

Çdo kërkesë e dërguar nuk mund të përfshijë më shumë se tri mbetje voluminoze.

Gjithësesi, Bashkia e Himarës rezervon të drejtën, që në rastet e kërkesave të veçanta, të cilat do të vlerësohen në çdo rast, të autorizojë mënyra të ndryshme mbledhjeje me qëllim marrjen e një numri më të madh mbetjesh voluminoze se sa përcakton rregullorja.

Shërbimi do të kryhet nga mjetet e bashkisë pa pagesë një herë çdo dy javë dhe përfituesit janë ekskluzivisht qytetarët e Bashkisë Himarë.

Do të jetë detyrë e bashkisë të njoftojë klientët lidhur me ditën kur do të kryhet mbledhja e mbetjeve.

#### **Neni 5**

### **Mënyra e dhënies së shërbimit**

Materialet voluminozë duhet të vendosen nga ana e klientit, në ditën e parashikuar, pranë banesës së tij, në katin përdhe me akses nga rruga, të mirësishtuar, në mënyrë që manovrimet për marrjen e tyre nga ana e mjetit transportues dhe operatorëve të shërbimit, të kryhen në kohën e duhur pa shkakuar vonesa në kohë.

Klienti që merr shërbimin është i detyruar t'i vendosë mbetjet në mënyrë të rregullt, duke zenë minimumin e sipërfaqes publike dhe gjithësesi, në mënyrë të tillë që të mos pengojë qarkullimin dhe/ose parkimin e mjeteve.

#### **Neni 6**

### **Dispozita për subjektet private**

Titullarët e subjekteve private prodhuese artizanale, industriale, tregëtare dhe të shërbimit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e bashkisë nuk përfitojnë shërbimin në banesë.

### **Neni 7** **Dorëzimi i mbetjeve vegjetale dhe inerte**

Përfshihen nga shërbimi i mbledhjes së mbetjeve voluminoze në banesë materialet vegjetale me origjinë nga krasitja, qethja e barit dhe mirëmbajtja e kopshteve të kryera nga qytetarët privatë, si dhe materialet inerte me origjinë nga shkatërrimet e vogla si rezultat i punimeve ndërtimore në banesa (si p.sh pllaka veshjesh, aparate hidrosanitare, etj.).

Përfshihen nga rregulli i mësipërm për mbetjet vegjetale, bëjnë rastet e personave të moshuar mbi 60 vjeç dhe me aftësi të kufizuara dhe pa të afërm që mund të përkujdesen për ta.

Mbetjet vegjetale me origjinë nga krasitja, qethja e barit dhe mirëmbajtja e kopshteve duhet të dorëzohen në Qendrën Ekologjike Bashkiake (Stacioni i Transferimit).

Gjatë ushtrimit të shërbimit, si personeli i bashkisë, ashtu edhe klientët, duhet të respektojnë të gjitha dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi apo që do të dalin më vonë, si dhe Rregulloren e Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë Himarë.

### **Neni 8** **Norma integruese**

Për gjithçka nuk është e shprehur dhe e përfshirë në këtë rregullore, si normativë referuese do të merret normativa në fuqi.